

STUDIM PËR SHKALLËN E REFUZUESHMËRISË SË VIZAVE NË KOSOVË

Ulja e shkallës së refuzueshmërisë së Vizave Shengen për qytetarët e Kosovës

Dhjetor, 2013

Opinionet e shprehura në këtë dokument janë opinionet e të anketuarve gjatë anketës dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë qëndrimet e UNDP apo USAID

Përmbajtja;

Lista e shkurtesave	3
1. Hyrje	4
2. Informata të përgjithshme	6
3. A janë statistikat reale?.....	9
4. Gjetjet e Raportit të Pulsit Publik.....	11
5. Çështjet me procesin e aplikimit për vizë	15
6. Si të zgjidhet ky problem?.....	16
7. Rekomandime.....	18

Lista e shkurtesave

BH	Bosnja dhe Hercegovina
KE	Komisioni Evropian
ESI	Iniciativa Evropiane për Stabilitet
BE	Bashkimi Evropian
GAP	Instituti GAP
KDPB	Këshilli për Drejtësi dhe Punë të Brendshme
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
KTV	Televizioni Kohavision
LTV	Vizë me Vlefshmëri të Kufizuar Territoriale
SHA	Shtetet anëtare të BE-së

1. Hyrje

Kosova¹ vazhdon të jetë e vetmja në Ballkanin Perëndimor që ende ka regjim të vizave në zonën Shengen. Ky regjim i vizave jo vetëm që përbën pengesë për lirinë e lëvizjes së njerëzve duke i bërë ata më të izoluarit në botë, por edhe pengon perspektivën e zhvillimit ekonomik për të cilën ka shumë nevojë ky vend. Bashkimi Evropian (BE) ka dhënë zotime politike për liberalizimin e regjimit afatshkurtër të vizave me Kosovën në Agjendën e Selanikut në qershor 2003.² Që atëherë, qeveria e Kosovës ka pranuar një varg parakushtesh që duhet të përmbushen para se të fillojë dialogu për liberalizimin e vizave. Këto parakushte kryesisht kanë të bëjnë me proceset e ripranimit dhe riintegrit. Në janar 2011, BE vlerësoi pozitivisht përpjekjet e autoriteteve të Kosovës, posaçërisht për sa i përket atyre në fushën e ripranimit dhe riintegrit. Pas kësaj, Komisioni Evropian (KE) e sollë Kosovën në rrugën e liberalizimit të vizave Shengen kur zyrtarisht hapi dialogun për liberalizimin e vizave me Kosovën.

Si rrjedhojë, autoritetet e Kosovës kanë pranuar një numër kriteresh për t'i përmbushur para se kosovarët të lejohen të udhëtojnë pa viza në shtetet e Shengenit. Ndonëse këto kushte duken të ngjashme me ato të listuara në udhërrëfyesit e shteteve të tjera të Ballkanit Perëndimor (d.m.th. masat për sa i përket sigurisë në kufij, sigurisë së dokumenteve, lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, etj.), ato kryesisht bazoheshin në indikatorë numerikë. Kjo do të thotë se metodologjia e përdorur për të hartuar udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave për Kosovën dallon nga metodologjia e përdorur për hartimin e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave për shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka realizuar një vlerësim krahasues të procesit të liberalizimit të vizave të BE-së në Ballkanin Perëndimor. Raporti i tyre nënvizon se “udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave për Kosovën dallon në disa mënyra krahasuar me atë të vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor. Përgjithësisht vlerësohet se Kosova i nënshtrohet standardeve më të shumta, mekanizmave të përforcuar të monitorimit, një procesi më të rreptë dhe në faza të vlerësimit dhe një procedure më komplekse të vendimmarrjes. Kosova përballet me procedura më të rrepta dhe qëndrim më të pafavorshëm të brendshëm dhe të BE-së.” Ndonëse qeveria e Kosovës ka filluar të ndërmarë hapa për përmbushjen e kriterëve të BE-së për liberalizim të vizave, ende ka shqetësime për sa i përket zbatimit të ngadaltë të ligjeve të reja të miratuara. Në të njëjtën kohë, numri i aplikacioneve të pasuksesshme për viza Shengen vazhdon të mbetet relativisht i lartë. Megjithatë, situata në këtë fushë është përmirësuar viteve të fundit ku shkalla e refuzimit të vizave ndryshon nga 17³ dhe 25 për qind⁴. Si pasojë, kjo ka shtuar frikën tek institucione të caktuara të BE-së dhe shtete anëtare të BE-së se largimi i mundshëm i regjimit të vizave do të mund të çonte në një valë të migruarve nga Kosova.

¹ Të gjitha referencat për Kosovën në këtë dokument janë në kontekst të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999)

² Komisioni Evropian. “Liberalizimi i vizave me Kosovën* - Udhërrëfyes”. http://ec.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_travel/visa_liberalization_with_kosovo_roadmap.pdf (f. 1, Bruksel, qershor 2012).

³ Instituti GAP dhe Grupi për Studime Ligjore dhe Politike. “Çështja e vizave – Raport për koston e vizave për kosovarët për periudhën 2010-2012. Prishtinë, 2013. Në dispozicion në: http://www.institutigap.org/documents/91619_gap_visas_eng.pdf

⁴ Këto shifra janë dhënë gojarisht në një intervistë me një diplomat të një shteti të Shengenit. Disa ambasada në Kosovë kanë refuzuar të ofrojnë të dhëna për numrin e aplikacioneve të pranuar për viza Shengen, refuzimet e aplikacioneve për viza si dhe statistika për arsyet e refuzimit.

Anketa e UNDP-së Pulsi Publik ka gjetur se qytetarët e Kosovës konsiderojnë se liberalizimi i vizave është çështje shumë e rëndësishme sepse rreth 90% e respondentëve kanë theksuar se liberalizimi i vizave është çështje e rëndësishme për ta. Pritjet e kosovarëve për të përfituar nga liberalizimi i vizave janë ngritur gjatë disa viteve të fundit dhe opinioni publik nuk i ka pritur pozitivisht zvarritjet në këtë proces. Duke pasur parasysh këtë situatë, ne kemi realizuar një hulumtim për gjendjen aktuale të procesit të liberalizimit të vizave. Raporti ynë ka ofruar rekomandime të cilat do të ndihmojnë në zgjidhjen e çështjeve të mbetura duke rezultuar me vendosjen e shpejtë të Kosovës në Listën e Bardhë të Shengenit. Një valë e migruesve joligjorë veçse ka shkaktuar shqetësime në disa shtete të BE-së për sa i përket liberalizimit të vizave për Kosovën. Numri i migruesve joligjorë nga shtetet fqinje të Kosovës më herët ka ngritur shqetësime në BE deri në masën e pezullimit të liberalizimit të vizave me shtetet që veçse kishin përfituar nga regjimi i liberalizimit të vizave. Qysh në shtator 2013, BE-ja ka debatuar për mundësinë e pezullimit të regjimit të liberalizimit të vizave për shtetet nga të cilat kanë prejardhjen numra të mëdhenj të migruesve ilegalë. Raporti i Progresit i BE-së 2013 për Kosovën thekson numrin e rritur të migruesve të parregullt nga Kosova në disa shtete anëtare (SHA) të caktuara. Prandaj, çështjet e refuzimeve të aplikacioneve për viza dhe migrimi joligjor janë thellësisht të lidhura dhe duhet të trajtohen së bashku për sa i përket regjimit të liberalizimit të vizave dhe politikave që kanë për qëllim uljen e migrimit të parregullt. Çështjet teknike vetëm sa e kanë përkeqësuar edhe më shumë këtë situatë. Viteve të fundit, statistikat e BE-së për sa i përket shkallës së refuzimeve të vizave në Kosovë kanë ngritur shqetësime tek autoritetet e Kosovës.

Meqë disa shtete Shengen nuk e kanë njohur Kosovën si shtet sovran, të gjitha aplikacionet kosovare për viza standarde janë refuzuar dhe në vend të tyre janë lëshuar viza me kufizime territoriale (d.m.th. duke përfshirë shtetet të cilat ende nuk kanë njohur shtetësinë e Kosovës). Kjo ka çuar në konfuzion për sa i përket shkallës aktuale të refuzimit të vizave dhe artificialisht ka fryrë numrat e refuzimeve të aplikacioneve për viza që paraqiten në statistika dhe pse shifrat e EUROStat dhe DP për Punë të Brendshme dallojnë nga ato të grumbulluara nga ambasadat e shteteve të Shengenit në Kosovë. Në anën tjetër, qytetarët e Kosovës ankohen se procedurat dhe kërkesat për marrjen e vizave janë të vështira dhe ato ndryshojnë nga njëra ambasadë në tjetrën, përkundër harmonizimit të kërkesave në aplikacione për viza në fillim të këtij viti. Edhe shtetet e Shengenit edhe autoritetet e Kosovës mund të ndihmojnë në përmirësimin e situatës dhe zvogëlimin e numrit potencial të aplikacioneve të refuzuara për viza, si dhe të sigurojnë një proces më të shpejtë të liberalizimit të regjimit të vizave dhe të ulin numrin e migrimit joligjor. Në këtë kontekst, Qeveria ka vënë theksin në parandalimin e migrimit të parregullt, luftën kundër grupeve kriminale të përfshira në lehtësimin e kontrabandës dhe kontrabandën e drejtpërdrejtë të migruesve dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Në vitin 2010 dhe 2011, Ministria e Punëve të Brendshme realizoi një fushatë informuese që kishte për qëllim dekurajimin e kosovarëve nga migrimi i parregullt. Kjo fushatë përfshinte paralajmërime për rreziqet e përpjekjeve të tilla. Megjithatë, me qëllim të intensifikimit dhe zgjerimit të fushatës informuese, më 2012, Ministria e Integritimit Evropian organizoi fushata të rregullta mediale për t'i informuar qytetarët për procesin e liberalizimit të vizave, ripranimit dhe riintegritimit për të dekurajuar migrimin joligjor.⁵ Megjithatë, nevojiten më shumë hapa konkretë dhe të vazhdueshëm për të ulur numrin e migruesve joligjorë dhe për të pasur ndikim në shkallën e refuzimit të vizave. Në periudhën afatgjatë nevojiten politika të mira që do të krijojnë vende pune dhe mirëqenie sociale për të zbutur apo eliminuar në tërësi këtë problem.

⁵ Disa aktivitete tanimë të kryera mund të gjenden në faqen e internetit të Ministrisë: (<http://www.visalib.info/en>).

Opinionet e shprehura në këtë dokument janë opinionet e të anketuarve gjatë anketës dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë qëndrimet e UNDP apo USAID

2. Informata të përgjithshme

Perspektiva për liberalizim afatshkurtër të vizave me Kosovën erdhi si pjesë e Samitit Evropian të Selanikut në qershor 2003. Pas kësaj perspektive pasuan zotimet e SHA në dhjetor 2007. Në atë kohë, Këshilli Evropian konfirmoi zotimin e vitit 2003 dhe kërkoi nga KE që t'i shqyrtojë më tutje mundësitë e promovimit të kontakteve ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. Një muaj më vonë, KE filloi një dialog për liberalizimin e vizave me shtetet e Ballkanit Perëndimor. Këshilli shqyrtoi këtë çështje dhe planifikoi përgatitjen e udhërrëfyesve të hollësishëm për secilin shtet që do të mund të përfitojë nga liberalizimi afatshkurtër i vizave.

Në vitin 2008, pas hyrjes në fuqi të lehtësimit të vizave dhe marrëveshjeve të ripranimit, u lansua dialogu për liberalizimin e vizave me Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën (BH), Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë. Në dhjetor të vitit 2009, Këshilli vendosi të miratojë udhëtimin pa viza për shtetasit e Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Shqipëria dhe BH përfituan nga udhëtimi pa viza në dhjetor 2010. Kështu, Kosova mbeti e vetmja në Ballkanin Perëndimor pa regjim pa viza me BE-në. Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI), një think-tank për Evropën Juglindore pohoi në një raport se mosnjohja e Kosovës nga disa shtete anëtare është arsyeja kryesore pse Kosova u la jashtë regjimit pa viza⁶. Më 2010, ESI i bëri thirrje Këshillit që t'i largojë të gjitha paqartësitë dhe të jetë i vendosur prapa pozicionit se procesi vendimmarrës i liberalizimit të vizave do të jetë neutral ndaj statusit. Në takimin e tyre në dhjetor 2009, Këshilli kërkoi nga KE që të vazhdojë tutje me një qasje të strukturuar ashtu që Kosova gjithashtu të mund të përfitojë nga liberalizimi i vizave dhe të lëvizë më afër BE-së. Ky pozicion është marrë përkundër faktit që pesë shtete anëtare ende nuk e kanë njohur zyrtarisht Kosovën si shtet sovran. Në të ashtuquajturin Studim për Kosovën (nëntor 2009), Komisioni premtoi të themelojë Udhërrëfyesin për Viza për Kosovën dhe që pastaj të fillojë dialogun për liberalizimin e vizave. Megjithatë, kjo nuk është bërë kurrë në praktikë. Dialogu dhe Udhërrëfyesi janë nisur vetëm pas disa viteve. BE-ja ka theksuar se para se të fillojë dialogu për viza me Kosovën duhet të arrihet progres i mëtejshëm në fushën e ripranimit dhe riintegritimit. Në dhjetor 2011, Këshilli ka mirëpritur vendimin e KE-së për fillimin e dialogut për viza me Kosovën pa paragjykim të qëndrimit të shteteve anëtare për statusin e Kosovës. Disa ditë më vonë, Këshilli për Drejtësi dhe Punë të Brendshme nisi një diskutim për progresin e Kosovës për ripranimin dhe riintegritimin.

KE nxori përfundimin se “Kosova ka arritur progres të kënaqshëm në krijimin e një kornize të politikave për riintegritimin e të kthyerve në Kosovë, siç kishte vepruar tanimë në rastin e ripranimit.”⁷ KE është zotuar se do të vazhdojë me monitorimin dhe vlerësimin e progresit të Kosovës në avancimin e kornizës së saj të ripranimit dhe riintegritimit efektiv të të kthyerve. Ky proces ka shënuar progres të mëtejshëm më 19 janar 2012 kur KE lansoi dialogun për viza me Kosovën. Hapi i ardhshëm ishte prezantimi i Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave tek Qeveria e Kosovës që është dorëzuar në qershor 2012 nga Komisionarja e BE-së për Punë të Brendshme, Cecilia Malmström. Atë kohë, Kosova është kërkuar që të miratojë apo ndryshojë një numër të madh të akteve ligjore në pajtim me legjislacionin evropian dhe të ndërmarrë masa konkrete për t'i

⁶ Iniciativa Evropiane për Stabilitet. “Izolimi konfirmoi si BE-ja po minon interesat e saj në Kosovë, Berlin - Bruksel – Prishtinë,” nëntor 2010. Në dispozicion në: http://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_119.pdf

⁷ Komisioni Evropian. “Liberalizimi i vizave me Kosovën* - Udhërrëfyes”. http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_travel/visa_liberalization_with_kosovo_roadmap.pdf (f. 2, Bruksel, qershor 2012).

Opinionet e shprehura në këtë dokument janë opinionet e të anketuarve gjatë anketës dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë qëndrimet e UNDP apo USAID

përbushur këto kritere. Sipas Udhërrëfyesit, KE ishte e obliguar që të prezantojë raporte të rregullta tek institucionet tjera të BE-së duke vlerësuar përpjekjet e Kosovës për përbushjen e agjendës legislative të përcaktuar në Udhërrëfyes. Gjithashtu, nga KE është kërkuar që rregullisht të rivlerësojë ndikimet e pritura të migrimit dhe sigurisë të regjimit të vizave me Kosovën.⁸

Për më tepër, KE do të vazhdojë të monitorojë dhe raportojë për progresin e Kosovës duke marrë parasysh indikatorët tjerë si:

- Shkalla e refuzimit të vizave për aplikuesit nga Kosova;
- Shkalla e refuzimit të hyrjes në zonën Shengen për qytetarët e Kosovës;
- Numri i qytetarëve të Kosovës me qëndrim ilegal në territor të shteteve anëtare;
- Numri total i aplikacioneve për azil nga qytetarët e Kosovës; dhe
- Numri i aplikacioneve të refuzuara të ripranimit të dorëzuara nga SHA në Kosovë për qytetarët e Kosovës.⁹

Udhërrëfyesi ka theksuar që do të përdoret një ulje e konsiderueshme në indikatorët e mësipërm të performancës në vlerësimin e Komisionit për ndikimet e pritura të migrimit dhe sigurisë së liberalizimit të mundshëm të vizave me Kosovën. Në prill të vitit 2013, Ministria e Integritimit Evropian prezantoi Planin e Veprimit për Implementim të Udhërrëfyesit të Liberalizimit të Vizave. Plani përfshinte një listë të veprimeve të cilat duhet t'i ndërmarrin autoritetet e ndryshme kosovare për t'i përbushur kriteret dhe rekomandimet e BE-së. Plani parashihte zbatimin e kornizës gjithëpërfshirëse ligjore të kërkuar me Udhërrëfyes si dhe ndarjet e nevojshme buxhetore dhe aktivitetet për ngritje të kapaciteteve.¹⁰ Gjithashtu, Plani parashihte negociatat dhe, nëse është e mundur, nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për bashkëpunim në fushën e ripranimit, veçanërisht me Kroacinë, Estoninë, Letoninë, Irlandën, Italinë, Maqedoninë, Turqinë dhe Lihtenshtajnin.

Autoritetet e Kosovës kanë investuar resurse të konsiderueshme për zbatimin e Planit të Veprimit. Buxheti për këtë qëllim është €19,158,000, pa shpenzime tjera administrative. Në kulm të pritjeve kosovare për liberalizim të vizave, një valë e migruesve ilegalë të Kosovës u bë çështje tejet shqetësuese. Në përpjekje për të ulur migrimin joligjor, Ministria për Integrim Evropian, Vlora Çitaku, tha për mediat se Evropa nuk do të pranonte më migrues nga Kosova dhe se migrimi jo i rregullt paraqiste pengesën më të madhe për liberalizimin e pritur të vizave. Edhe partitë opozitare shprehen mendimet e tyre për këtë situatë, duke fajësuar qeverinë e tanishme për gjendjen e vështirë ekonomike, që sipas tyre detyron qytetarët të largohen nga Kosova në kërkim të kushteve më të mira ekonomike dhe mundësive jashtë vendit. Televizioni Kohavision (KTV) raportoi se BE-ja mund të vendosë kushte shtesë për liberalizim të vizave për Kosovën, meqë numri i azilkërkuesve nga Kosova ishte rritur gjatë muajve të mëparshëm.¹¹ Në prill 2013, shtetet anëtare aktive në lëshimin e vizave Shengen në Kosovë harmonizuan listën e dokumenteve të nevojshme për të aplikuar për vizë. Mes tjerash ato përfshinin edhe certifikatat e lindjes. Megjithatë, në fillim të vitit 2013, Regjistri Civil

⁸ Po aty, f. 3.

⁹ Po aty, f. 15.

¹⁰ Ministria e Integritimit Evropian. "Plani i Veprimit për Implementim të Udhërrëfyesit të Liberalizimit të Vizave." Në dispozicion në: http://www.mei-ks.net/repository/docs/VLAP_2013_Eng.pdf (Prishtinë, prill 2013).

¹¹ Raport i lajmeve në Kohavision KTV, 15 korrik 2013. "Azili dëmton liberalizimin e vizave."

Opinionet e shprehura në këtë dokument janë opinionet e të anketuarve gjatë anketës dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë qëndrimet e UNDP apo USAID

mori vendim të lëshojë vetëm “ekstrate të regjistrave të lindjes” në vend të certifikatave të plota të lindjes. Ky problem bëri që të rritet numri i aplikacioneve të refuzuara për viza.

Në korrik 2013, Kuvendi Komunal ka miratuar një pako prej tetë ligjeve të kërkuara nga BE-ja në kuadër të Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave. Shumica e partive opozitare kanë kritikuar këtë proces, por, përfundimisht, kanë mbështetur miratimin e këtyre ligjeve që paraqiti një hap të rëndësishëm drejt liberalizimit të vizave. Shoqëria civile gjithashtu ka pasur ankesa se ky grup i ligjeve është miratuar pa konsultime publike, gjë që kërkohet me ligj. Gjithashtu, në korrik të vitit 2013, mediat raportuar se autoritetet qeveritare është dashur t'i ndërmarrin rreth 70 veprimet e mbetura për marrjen e liberalizimit të vizave.¹² Po këtë muaj, Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës dhe Hungarisë nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi për të luftuar krimin ndërkufitar, duke përfshirë trafikimin me qenie njerëzore.

Pastaj, në gusht 2013, Përfaqësuesi i BE-së në Kosovë lajmëroi se kosovarët do ta mësojnë planin kohor për liberalizimin e vizave në shtator. Në mes të muajit shtator, Parlamenti Evropian miratoi ndryshimet për rregullimin e BE-së për viza duke përfshirë një mekanizëm të ri për pezullimin e tërheqjes së vizave, për të siguruar se udhëtimi pa viza nuk çon në parregullsi apo keqpërdorime. Ndonëse liberalizimi i vizave ka qenë temë e rregullt e diskutimit gjatë tërë vitit 2013 dhe pas liberalizimit të vizave me shtetet fqinje, kur u bë e qartë se liberalizimi i vizave me BE-në nuk do të jetë detyrë e lehtë, qeveria filloi të mos flasë për këtë temë në publik. Në vend të kësaj, Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim u bë temë e rregullt e diskutimit edhe për qeverinë edhe për mediat.

¹² Edicioni i Lajmeve në RTV21. “Detyrat për liberalizim të vizave.” (Prishtinë, 6 korrik).

3. A janë statistikat reale?

Që një shtet të përfshihet në Listën e Bardhë të Shengenit, besohet që shkalla e refuzimit të vizave nuk duhet të jetë e lartë. Sot, statistikat e refuzimeve të vizave Shengen në Kosovë janë të paqartë dhe jo të besueshme. Siç është theksuar më lartë, statistikat e BE-së, ambasadave të shteteve të Shengenit dhe të BE-së dhe statistikat e raporteve të shoqërisë civile dallojnë në këtë çështje.

Problemi kryesor qëndron në faktin që Kosovën nuk e kanë njohur si shtet sovran të gjitha shtetet anëtare. Praktikisht, kjo do të thotë se kur qytetarët e Kosovës aplikojnë për viza, ato nuk marrin Vizë Shengen C, por atyre u lëshohen të ashtuquajturat Viza me Vlefshmëri të Kufizuar Territoriale (LTV). LTV zakonisht përjashton udhëtimet në shtetet të cilat ende nuk e kanë njohur Kosovën dhe kjo është pse këto viza njihen si “viza minus” në Kosovë. Në të njëjtën kohë, një situatë e tillë ka bërë që institucionet të raportojnë se vizat C janë refuzuar, gjersa shumica e vizave LTV janë raportuar si të aprovuara. Kjo është gjeneza e dallimeve në raportim. Shqyrtimi i raportit të Komisionit¹³ për Parlamentin dhe Këshillin Evropian për progresin e Kosovës në përmbushjen e kërkesave për Udhërrëfyesin e Liberalizimit të Vizave jep një indikacion të qartë të këtij problemi.

Statistikat për refuzimin e vizave në Kosovë për viza afatshkurtëra Shengen gjatë periudhës 2010-2011, të siguruara nga DP për Punë të Brendshme të KE, tregojnë një mospërputhje të madhe kur i krahasojmë me shifrat e siguruara nga ambasadat e shteteve anëtare. Kur janë krahasuar të dhënat për shkallën e refuzimit të vizave me ato të Eurostatit, është konstatuar se statistikat e Eurostatit nuk paraqesin shkallën e vërtetë të refuzimit të vizave në Kosovë. Sipas analizës së Eurostatit, të gjitha aplikacionet për viza C janë kategorizuar si të refuzuara. Njëkohësisht, LTV-të janë raportuar si të aprovuara pa u zbritur nga numri total i aplikacioneve të refuzuara për viza. Për shembull, raporti i Eurostatit tregon se Finlanda ka refuzuar 99.2% të Viza Shengen A dhe C. Megjithatë, nga analiza e statistikave të siguruara nga Ambasada Finlandeze në Kosovë atë vit shihet se Ambasada ka pranuar 916 aplikacione për viza nga të cilat 776 viza A, C dhe LTV janë aprovuar përfundimisht. Kjo do të thotë se shkalla aktuale e refuzimit të vizave nga ambasada finlandeze është 15.3%, jo 99.2%.

Ngjashëm, të dhënat e siguruara nga ambasada italiane tregojnë se kjo ambasadë ka pranuar 9.942 aplikacione për viza në gjysmën e parë të vitit 2013, nga të cilat 7.843 janë aprovuar, gjë që paraqet një shkallë të refuzimit të vizave prej 21.11%. Gjatë të njëjtës periudhë kohore të vitit të kaluar, kjo ambasadë ka pranuar 8.473 aplikacione dhe ka lëshuar 6.518 viza, që paraqet shkallë të refuzimit prej 23.07%. Krahasimi i të dhënave tregon një zvogëlim në aplikacionet e refuzuara për viza. Situata me të dhënat e ambasadës gjermane është e ngjashme. Sipas të dhënave të Eurostatit duket se Gjermania ka refuzuar 79.24% të aplikacioneve për viza, por as këto shifra nuk pasqyrojnë situatën reale. Sipas të dhënave të siguruara nga Ambasada Gjermane, shkalla e refuzimit për aplikacionet për viza C ishte vetëm 18% për qind. Është e pamundur që të bëhet një vlerësim i pavarur i shkallës së refuzimit të vizave në ambasadat tjera të cilat lëshojnë viza Shengen në Kosovë pa të dhëna të papërpunuara. Në anën tjetër, është dëshmuar si e pamundur për autorët e këtij raporti që të sigurojnë të dhëna të papërpunuara drejtpërsëdrejti nga ambasadat tjera të BE-së në Kosovë. Megjithatë, besohet se të njëjtat llogaritje të gabuara (siç ishte rasti me ambasadën finlandeze, italiane dhe gjermane) vlejnë edhe për lëshuesit tjerë të vizave Shengen në Kosovë.

¹³ Komisioni Evropian. “Raport i Komisionit Evropian për Parlamentin dhe Këshillin Evropian për progresin e Kosovës* në përmbushjen e kërkesave të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave.” Bruksel, 8 shkurt 2013.

Opinionet e shprehura në këtë dokument janë opinionet e të anketuarve gjatë anketës dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë qëndrimet e UNDP apo USAID

Këto statistika të paharmonizuara të aplikacioneve për viza shkaktojnë konfuzion si për vendimmarrësit ashtu edhe për palët e interesit në BE për sa i përket procesit të liberalizimit të vizave me Kosovën. Siç kanë theksuar diplomatët nga zona Shengen se numri i aplikacioneve të refuzuara për viza duhet të pësojë rënie, vlen të përsëritet se analizat e mësipërme të të dhënave nga ambasada gjermane, finlandeze dhe italiane kanë treguar se shkallët e refuzimit të vizave në secilën nga këto ambasada ishte nën 20-25%. Përveç kësaj, hulumtimet e shoqërisë civile në Kosovë kanë gjetur se gjatë tri viteve të kaluara, 217.862 kosovarë kanë aplikuar për viza shengen: 82.450 më 2010, 67.901 më 2011 dhe 67.556 më 2012. Të dhënat e tyre tregojnë se vetëm 17% të aplikacioneve për viza janë refuzuar nga shtetet Shengen.¹⁴ Është planifikuar që ky raport të përfshijë edhe një analizë gjithëpërfshirëse të arsyeve për shkallën e refuzimit të vizave sipas raportimeve nga ambasadat. Një analizë e tillë do ta bënte më të lehtë përshkrimin e rekomandimeve për atë se ku të vihet fokusi në të ardhmen për krijimin e politikave të cilat do të ulin shkallën e refuzimit të vizave. Në anën tjetër, këto politika do të ulnin numrin e migruesve jo të rregullt në BE që është edhe një kriter tjetër për liberalizimin e vizave.

Përfaqësuesit e sipërpërmendur të shteteve Shengen kanë theksuar se arsyet kryesore për refuzim të aplikacioneve për viza janë:

- Aplikacionet jo të plota,
- Mjete të pamjaftueshme (qoftë të aplikuesit qoftë të palës pritëse), dhe
- Aplikacionet nga grupe të rrezikut (të moshës 18-24), të papunë, të pamartuar apo të paregjistruar në një institucion arsimor.

Arsyet tjera të raportuara përfshijnë:

- Shënime negative për aplikuesit në Sistemin Informativ të Shengenit apo Regjistrin e të Huajve të shteteve individuale (kryesisht njerëz të cilët më herët janë depërtuar në Kosovë), dhe
- Rastet e martesave të rrejshme.

Ndonëse këto informata janë të rëndësishme, nuk është e mundur të bëhet një analizë e plotë pa të dhëna të plota të papërpunuara nga të gjitha ambasadat e zonës së Shengenit. Është me rëndësi që ambasadat, në bashkëpunim të ngushtë me KE dhe qeverinë e Kosovës të kryejnë analiza të tilla të rregullta, së paku në baza vjetore, dhe të përdoren gjetjet për t'i përmirësuar politikat që kanë për synim përmbushjen e kërkesave nga Udhërrëfyesi.


¹⁴ Instituti GAP dhe Grupi për Studime Ligjore dhe Politike. "Çështja e vizave – Raport për koston e vizave për kosovarët për periudhën 2010-2012. Prishtinë, 2013. Në dispozicion në: http://www.institutigap.org/documents/91619_gap_visas_eng.pdf.

Opinionet e shprehura në këtë dokument janë opinionet e të anketuarve gjatë anketës dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë qëndrimet e UNDP apo USAID

4. Gjetjet e Raportit të Pulsit Publik


Ngjashëm me rezultatet e anketës Pulsi Publik të nëntorit 2010, rezultatet e fundit të anketës nga prilli 2013 tregojnë se çështja e liberalizimit të vizave vazhdon të ketë rëndësi të madhe për pjesën dërmuese të kosovarëve (90%). Megjithatë, ndarja e të dhënave në baza etnike tregon një dallim të madh në mendime. Gjersa 81% të shqiptarëve të Kosovës e konsiderojnë liberalizimin e vizave të Shengenit si shumë të rëndësishëm, vetëm 28% të serbëve të Kosovës konsiderojnë se kjo është çështje e rëndësishme. Përveç kësaj, 10% e serbëve të Kosovës mendojnë se kjo çështje është tërësisht e parëndësishme. Megjithatë, është supozuar se liberalizimi i vizave për Kosovën rrjedhimisht do të jetë më pak i rëndësishëm për serbët e Kosovës sepse ata kanë qasje në pasaporta të Serbisë (shih Figurën 1).

Figura 1. Opinione për rëndësinë e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës



Të dhënat e anketës gjithashtu kanë paraqitur arsyet pse njerëzit konsiderojnë se liberalizimi i vizave është i rëndësishëm. Përkundër situatës tejet të vështirë ekonomike në Kosovë, është inkurajues fakti që shumica e kosovarëve janë përgjigjur se do ta përdorin regjimin e udhëtimit pa viza për qëllime turistike (35% të respondentëve, krahasuar me 20% në nëntor 2010), vizita familjare (26%), mundësi për shkollim dhe arsye të tjera. Megjithatë, një numër mjaft i madh i respondentëve kishin keqkuptime lidhur me liberalizimin e vizave ku kanë deklaruar se ata do ta përdornin këtë mundësi për të kërkuar punësim apo banim të përhershëm në BE (16%) (shih Figurën 2).


Figura 2: Në rast të liberalizimit të vizave, cili do të jetë qëllimi kryesor i udhëtimit tuaj në shtetet evropiane



Opinionet e shprehura në këtë dokument janë opinionet e të anketuarve gjatë anketës dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë qëndrimet e UNDP apo USAID


Për të përcaktuar se cilët faktorë demografikë kanë ndikuar në gatishmërinë e respondentëve për ta shfrytëzuar liberalizimin e vizave si mundësi për të kërkuar punësim apo banim të përhershëm në BE, është kryer një analizë statistikore ndërmjet përdorimit të liberalizimit të vizave si mundësi për të kërkuar punësim apo banim të përhershëm në BE dhe variablave në vijim: rajoni, gjinia, arsimi, të ardhurat, papunësia dhe vendi i banimit. Gjetjet kanë treguar se një numër i madh i qytetarëve në Gjakovë (28%), Gjiilan (25%), Prishtinë (20%) dhe Prizren (20%) do ta përdorin liberalizimin e vizave për të kërkuar punësim apo banim të përhershëm në BE. Në rajone të tjera janë gjetur përqindje më të ulëta të qytetarëve që kanë deklaruar se do ta përdorin liberalizimin e vizave për të njëjtat qëllime.

Figura 3: Përdorimi i liberalizimit të vizave për punësim dhe qëllime të lejes së qëndrimit – analizë krahasuese e të dhënave



Për më tepër, analiza jonë tregoi se shumica e personave që do ta përdornin liberalizimin e vizave për të kërkuar punësim dhe banim të përhershëm në BE janë të papunë (që kërkojnë punë) (31%), persona pa shkollim të mesëm të përfunduar (23%), meshkuj (20%), dhe persona që nuk kanë fituar fare (19%) dhe persona që jetojnë në zona urbane (19%).

Figura 4: Përdorimi i liberalizimit të vizave për punësim dhe qëllime të banimit të përbërshëm – analiza krahasuese të punësimit, ndarjes gjinore, të ardhurave, shkollimit dhe banimit



Respondentët gjithashtu janë pyetur se çka mendojnë se është arsyeja që Kosova vazhdon të jetë e vetmja në rajon pa regjim pa viza. Gjetjet tregojnë se shumica e tyre (28%) mendonin se kjo ishte “sepse qeveria e Kosovës dhe institucionet tjera të Kosovës nuk i kanë përmbushur kriteret e nevojshme sipas udhërrëfyesit të liberalizimit të vizave,” 15% kanë deklaruar se kjo ishte për shkak të “problemeve që Kosova i ka me Serbinë,” dhe 14% kanë deklaruar që kjo është për shkak se “pesë shtete të BE-së nuk e kanë njohur Kosovën” (shih figurën 5).

Figura 5: Pse mendoni se Kosova është jashtë dialogut të vizave



Kosovarët gjithashtu janë pyetur nëse kanë aplikuar për viza gjatë gjashtë muajve të fundit nga të cilët 6% janë përgjigjur pozitivisht. Shumica e atyre që kanë aplikuar (3.9 %) kanë marrë viza, ndërsa 2.2% jo. Kjo tregon se shkalla e përgjigjes negative në aplikacione të vizave është më e lartë sesa shkalla e refuzimit e supozuar në ambasada.

Figura 1. Nëse po, a u është dhënë viza?

	Shqiptar	Serb	Të tjerë	Gjithsej
Po (një hyrje)	2.1%	3.9%	4.1%	2.2%
Po (shumë hyrje)	1.5%	3.9%	4.1%	1.7%
Jo	2.3%	2.0%		2.2%
Ende pres përgjigje	0.2%	2.0%	2.0%	0.3%
NA	94.0%	88.2%	89.8%	93.6%

Gjithashtu, kosovarët janë pyetur nëse e dinin që nëse migrojnë ilegalisht, do të kthehen në Kosovë dhe nëse janë të informuar se Kosova ka nënshkruar marrëveshje të ripranimit me shumicën e shteteve anëtare të BE-së? Gjashtëdhjet e nëntë për qind të respondentëve kanë deklaruar se janë në

dijeni se do të kthehen në Kosovë nëse migrojnë ilegalisht, ndërsa 18% kanë thënë se nuk e kanë pasur këtë informatë. Nga ata që nuk e kanë ditur se do të ktheheshin, 26% ishin serbë, 18% shqiptarë dhe 10% pjesëtarë të komuniteteve tjera të Kosovës. Në anën tjetër, më shumë se 52% të të gjithë respondentëve ishin të informuar se Kosova ka nënshkruar marrëveshje të riprimit me shumicën e shteteve anëtare. Megjithatë, 34% të serbëve të Kosovës, rreth 61% pjesëtarë të komuniteteve tjera të Kosovës dhe 30% shqiptarë të Kosovës nuk ishin të informuar për këtë.

Përveç kësaj, më shumë se gjysma e respondentëve ishin në dijeni se nëse migrojnë ilegalisht, ata nuk do të mund të hyjnë në zonën Shengen për një periudhë prej tri deri pesë vite, gjersa rreth 28 për qind nuk ishin në dijeni për këtë pasojë. Ky numër është mjaft i lartë dhe kërkohen fushata të vetëdijesimit apo masa të tjera të cilat do t'i informojnë qytetarët duke shpresuar se më pak njerëz do të bëjnë përpjekje për t'u zhvendosur ilegalisht në zonën e Shengenit.

Nga respondentët të cilët ishin të interesuar në marrjen e vizave, 5% kanë deklaruar se u janë ofruar mënyra të paligjshme të marrjes së vizës. Tetë për qind të atyre që u është ofruar një mënyrë ilegale për marrjen e vizave kanë pohuar se kanë pranuar oferta nga stafi i ambasadës, gjersa 1% e aplikuesve kanë deklaruar se kanë pranuar oferta të tilla nga njerëz të cilët nuk kanë punë të përhershme.

5. Çështjet me procesin e aplikimit për vizë

Kosova nuk ka nënshkruar marrëveshje për lehtësim të vizave para fillimit të procesit të liberalizimit të vizave që do të mund të kishte lehtësuar procedurat e aplikimit për vizë. Megjithatë, hulumtimi i kryer në vendet e rajonit (si Maqedoni, Shqipëri, Serbi, etj.) ka treguar se lehtësimi i vizave nuk ka siguruar mbështetje të konsiderueshme për aplikuesit. Në fakt, në disa raste, vlente e kundërta. Aplikuesit për vizë janë ankuar se procedurat për marrjen e vizave janë të vështira dhe se procedurat dhe kërkesat e aplikimit për viza ndryshojnë nga ambasada në ambasadë.

Siç është theksuar më herët, që nga prilli 2013, shtetet që lëshojnë viza kanë ndërmarrë hapa për harmonizimin e listës së dokumenteve të kërkuara. Ky zhvillim ka bërë që njerëzit të jenë më të informuar për dokumentet që duhet t'i dorëzojnë bashkë me aplikacionin e tyre për viza. Megjithatë, janë regjistruar disa raste ku artistët dhe gazetarët janë ankuar publikisht se përkundër faktit që kishin pasur disa viza të mëhershme Shengen, ata kohëve të fundit kanë marrë vetëm zgjatje të vizave për kohëzgjatjen e ngjarjeve të caktuara në zonën Shengen. Ata kanë kërkuar që të marrin viza me vlefshmëri më të gjatë dhe me hyrje të shumëfishta për t'i shmangur procedurat e aplikimit për viza në të ardhmen. Për t'i përmirësuar situatat e tilla, ambasada gjermane së fundi ka ndërmarrë një nismë të lehtësimit të procesit të aplikimit për viza për personat që kanë marrë vizë Shengen gjatë 24 muajve të fundit dhe atyre që kanë dëshmi se i kanë ushtruar të drejtat dhe privilegjet e tyre në mënyrë të përgjegjshme. Qytetarët që aplikojnë për vizë Shengen shpeshherë ankohen se lista e dokumenteve të kërkuara për t'u dorëzuar me aplikacionin për viza janë të shumta dhe se procedurat administrative lokale e bëjnë të vështirë paraqitjen e të gjitha dokumenteve në kohë dhe pa telashe. Për më tepër, ata ankohen se një numër i dokumenteve të kërkuara, në fakt, janë të panevojshme.

Respondentët gjithashtu janë ankuar se duhet t'i dorëzojnë aplikacionet për viza personalisht. Aplikuesit rregullisht detyrohen të kalojnë periudha të gjata kohore duke pritur para ambasadave/konsullatave. Kjo është veçanërisht e vështirë gjatë periudhës së dimrit kur dorëzohen më së shumti aplikacione për viza. Veç kësaj, qytetarët janë ankuar edhe për pagesën për aplikacion për vizë e cila, prapë, ndryshon ndërmjet ambasadave. Ata besojnë se kjo pagesë do të duhej të eliminohej për qytetarët meqë Kosova tanimë ka hyrë në proces të integritimit në BE dhe liberalizimit të vizave.

Instituti GAP ka kryer një analizë të pagesave për aplikacione për viza që duhet t'i paguajnë kosovarët në ambasadat/konsullatat e vendeve të Shengenit. GAP ka nxjerrë përfundimin se në periudhën ndërmjet vitit 2010 dhe 2012, qytetarët e Kosovës kanë shpenzuar rreth 15 milionë euro në aplikacione për viza. Nëntë milionë janë shpenzuar në pagesat direkte të tarifave për aplikacione për viza dhe së paku 5.8 milionë janë paguar në shpenzime për sigurimin e dokumenteve të ndryshme të nevojshme për t'i kompletuar aplikacionet për viza.¹⁵ Duke pasur parasysh gjendjen ekonomike në Kosovë, kjo shumë është mjaft e konsiderueshme.

¹⁵ Instituti GAP dhe Grupi për Studime Ligjore dhe Politike. "Çështja e vizave – Raport për koston e vizave për kosovarët për periudhën 2010-2012. Prishtinë, 2013. Në dispozicion në: http://www.institutigap.org/documents/91619_gap_visas_eng.pdf.

Opinionet e shprehura në këtë dokument janë opinionet e të anketuarve gjatë anketës dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë qëndrimet e UNDP apo USAID

6. Si të zgjidhet ky problem?

Qytetarët besojnë se mungesa e zbatimit të kritereve të Udhërrëfyesit nga ana e autoriteteve të Kosovës paraqet pengesën kryesore për liberalizimin e vizave. Anketa e Pulsit Publik konstatoi se pjesa më e madhe, 42% e respondentëve, fajin për këtë i vë mungesës së përgjithshme të kapaciteteve të qeverisë, ndërsa të tjerët kanë cekur faktorë të tjerë si gjendja ekonomike dhe imazhi i dobët i Kosovës tek shtetet anëtare. Autoritetet duhet t'i trajtojnë këto çështje duke përmbushur kërkesat e Planit të Veprimit, si dhe duke shtuar qarkullimin e informatave për opinionin publik pasi të jenë përmbushur standardet.

Plani i Veprimit për zbatimin e Udhërrëfyesit të liberalizimit të vizave ka paraparë një avancim të bashkëpunimit operacional në çështje të zbatimit të ligjit me shtetet e interesuara fqinje dhe shtetet anëtare. Megjithatë, përkundër një vale të kohëve të fundit të migruesve jo të rregullt nga Kosova që kalonin në drejtim të Serbisë për në Hungari dhe shtetet tjera anëtare, nuk është nisur asnjë bashkëpunim me Serbinë deri më sot. Siç është theksuar më lartë, në qershor 2013, Kosova ka nënshkruar një marrëveshje të bashkëpunimit me Hungarinë. Arritja e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet strukturave të sigurisë së Kosovës, Serbisë dhe Hungarisë do të mund të parandalonte migrimin ilegal. Përveç kësaj, marrëveshjet e ripranimit, fushatat informuese dhe aktivitetet tjera të zbatimit të ligjit kundër trafikimit të njerëzve duhet të konsiderohen si mjete për uljen e migrimit jo të rregullt. Megjithatë, është shumë e rëndësishme që të mos harrohet se duhet të formulohen zgjidhje afatgjate që trajtojnë papunësinë dhe gjendjen ekonomike të kosovarëve. Kjo do të mund të lehtësohej shumë përmes krijimit të marrëveshjeve për punësim sezonal ndërmjet Kosovës dhe shteteve të Shengenit apo shteteve anëtare të BE-së, si dhe duke bërë më shumë investime në shkollimin dhe aftësimin profesional, përmirësimin e sistemit arsimor në Kosovë, tërheqjes së më shumë investimeve të huaja dhe marrjes së masave të tjera që mund të kenë ndikim të konsiderueshëm afatmesëm dhe afatgjatë. Duhet të theksohet se disa shtete në rajon tanimë kanë marrëveshje të përhershme për këmbime të punësimit sezonal me disa shtete anëtare.

Përveç kësaj, nevojitet angazhim më i madh i autoriteteve të Kosovës me qytetarët për të siguruar se ata informohen dhe janë të vetëdijshëm se më nuk është e mundur që qytetarët e Kosovës të fitojnë azil dhe se ka pasoja ligjore të migrimit të paligjshëm. Rreth 28% të respondentëve nuk janë të informuar se migruesit e paligjshëm janë të ndaluar nga hyrja në zonën Shengen për një periudhë prej tre deri pesë vite. Fakti që Pulsit Publik ka konstatuar se vetëm 69% të respondentëve të tyre janë në dijeni se migruesit ilegalë do të kthehen në Kosovë, bën thirrje për më shumë fushata të informimit për të siguruar se opinioni publik informohet se migrimi ilegal nuk është opsion i mundur. Autoritetet përkatëse duhet të identifikojnë zonat prej nga vijnë migruesit dhe bashkë me komunat të angazhohen në fushata bazë për të siguruar se shpërndahen informatat e tilla.

Ndonëse Pulsit Publik ka gjetur se më pak se 2% e shqiptarëve të Kosovës dhe rreth 4% të pjesëtarëve të komuniteteve tjera të Kosovës do ta përdorin liberalizimin e vizave për zhvendosje në Evropën Perëndimore për arsye ekonomike, mediat kanë raportuar se arsyet e paraqitura nga migruesit ilegalë për përpjekjet e tyre për t'u zhvendosur në Evropën Perëndimore janë kryesisht ekonomike. Duke i pasur parasysh shifrat e fundit për migrimin ilegal, shtetet anëtare të BE-së dhe Komisioni Evropian kanë arsye për t'u shqetësuar për këtë trend. Prandaj, është me rëndësi që t'i kushtohet vëmendje speciale trajtimit të uljes së migrimit ilegal që pastaj do të zvogëlojë numrin e aplikacioneve të refuzuara për viza.

Autoritetet duhet të zbatojnë masa si këmbimet për punë sezonale, për të ulur presionet ekonomike ndaj shtresave ekonomikisht të pafavorshme të shoqërisë. Disa shtete të rajonit tanimë kanë marrëveshje të përhershme për këmbimin e punëtorëve sezonalë me disa shtete anëtare të BE-së. Meqë është hartuar dhe miratuar nga Kuvendi pakoja e ligjeve të kërkuara me Udhërrëfyes, fokusi tani duhet të jetë në zbatimin aktual të atyre ligjeve. Institucionet e Kosovës duhet të bëhen më kreative dhe gjithëpërfshirëse në trajtimin e çështjeve të ripranimit duke ofruar zgjidhje të qëndrueshme. Kjo, natyrisht, kërkon krijimin e vendeve të punës, biznese të reja, si dhe integrim social, arsimor dhe ekonomik për të kthyerit. Mandati i KE-së aktuale përfundon në mes të vitit 2014. Edhe Kosova edhe BE-ja duhet të përqëndrohen në përsheptimin e përpjekjeve dhe pajtimin për afatin kohor për arritjen e futjës së Kosovës në Listën e Bardhë të Shengenit para përfundimit të mandati të Komisionit aktual. Nëse kjo nuk arrihet në këtë mandat të Komisionit, për shkak të zgjedhjeve në BE, procesi i liberalizimit do të shtyhet edhe më shumë.

7. Rekomandime

Rekomandimet në vijim kanë për qëllim të trajtojnë disa prej çështjeve kryesore të ngritura dhe të sugjerojnë opsione për zgjidhje të shpejta, ndonëse në disa raste të përkohshme, para se procesi i liberalizimit të vizave të bëhet realitet për Kosovën.

Për Qeverinë e Kosovës;

1. Të themelohet Njësia Këshillëdhënëse për Viza në institucionet e Kosovës që të këshillojë aplikuesit për viza se si t'i dorëzojnë më së miri aplikacionet e suksesshme për viza Shengen. Gjithashtu, kjo njësi do t'i filtrojë njerëzit të cilët nuk i përmbushin kriteret për aplikim. Ndryshe, ambasadat dhe qeveria e Kosovës do të mund të financonin një shërbim profesional apo një organizatë të shoqërisë civile për t'i mbështetur aplikuesit për këtë qëllim deri në liberalizimin e vizave.
2. Të përmirësohet komunikimi për liberalizimin e vizave me opinionin publik. Të rritet numri i fushatave të informimit publik për t'i informuar qytetarët për pasojat e migrimit të paligjshëm. Duhet të bëhet një analizë e thellë e profilit të migruesve ilegalë për të siguruar fushata specifike për zona specifike problematike. Një analizë e tillë do t'i merrte parasysh të gjitha dimensionet: moshën, gjininë, fenë dhe përkatësinë etnike.
3. Të shtohet angazhimi me shtetet e Shengenit për arritjen e marrëveshjeve për këmbimin e punëtorëve sezonalë për të lehtësuar presionin social dhe ekonomik ndaj grupeve të cënueshme në Kosovë.
4. Të ngulet këmbë për një marrëveshje për bashkëpunim policor me Serbinë për të siguruar luftimin efektiv të trafikimit ndërkufitar.

Për shtetet që lëshojnë viza Shengen;

1. Të zbatohen masa të përkohshme. Këto duhet të përfshijnë: dhënien e vizave afatgjate për aplikuesit *bona fide* të cilët kanë pasur vizë Shengen në të kaluarën dhe të zbuten procedurat e verifikimit për poseduesit e vizave të mëhershme (shih shembullin gjerman).
2. Të harmonizohet lista e dokumenteve të kërkuara për aplikim për vizë në të gjitha shtetet e Shengenit dhe të sigurohet zbatimi i Kodit të Vizave Shengen nga të gjitha konsullatat e shteteve të Shengenit.
3. Të përmirësohet procesi praktik i aplikimit për vizë për t'i mundësuar aplikuesit që të kalojnë më shpejtë nëpër procesin e aplikimit dhe të eliminohen radhët e panevojshme duke aplikuar një sistem të pakushtueshëm të caktimit të takimeve.
4. Të vlerësohen dhe arsyet për refuzime për viza dhe të njëjtat t'i komunikohen qeverisë së Kosovës, shoqërisë civile dhe opinionit publik duke ofruar shifra të sakta të refuzimeve të aplikacioneve për viza. Në rastin më të mirë, kjo do të zvogëlonte numrin e migruesve jo të rregullt. Përveç kësaj, do të zvogëlohej ngarkesa e punës së ambasadës dhe stafit të zyrave qendrore për shkak të zvogëlimit pasues të verifikimeve.
5. Të iniciohen marrëveshjet për punësim sezonal me institucionet e Kosovës meqë kjo do të mundësonte përmirësime të situatës ekonomike të personave në nevojë dhe do të zvogëlonte nevojën e perceptuar për migrim jo të rregullt.

Për aplikuesit për viza;

1. Aplikoni për vizë së paku një muaj para udhëtimit.
2. Siguroni se janë përgatitur të gjitha dokumentet para se të aplikoni për vizë.
3. Mos migroni ilegalisht sepse me siguri do të riatëdhesoheni dhe do të futeni në bazë të të dhënave dhe do të ju refuzohet hyrja në Zonën Shengen për disa vite.

Për mediat dhe organizatat e shoqërisë civile;

1. Vazhdoni të informoheni për procesin e liberalizimit të vizave. Shqyrtoni dokumentet e BE-së dhe qeverisë së Kosovës për të siguruar raportim të saktë dhe që të mund të ofroni rekomandime përkatëse për këtë çështje.
2. Mbuloni më për së afërmi dialogun për liberalizimin e vizave. Mos mbuloni vetëm ngjarjet madhore, por hulumtoni dhe vlerësoni se janë arritjet e vërteta dhe ku ka mangësi.